



---

**VENDIM**

*Nr. 35, Datë 09.03.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROÇEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
LIÇENSËS PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma ‘ç’ të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e të Licensës për veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “draft - Liçensës për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike”.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**